



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPÇTINA VITINA

10.12.2015			
№ i gjatshëm	NUMRI	Shprehje	Udhë
01-013/1642			



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 36 paragrafi 2 pika c) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 08.12.2015 miraton këtë:

**V E N D I M**  
**PËR APROVIMIN E STRATEGJISË KOMUNALE KUNDËR DHUNËS**  
**NË FAMILJE DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2016-2018**

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, APROVON Strategjinë komunale kundër dhunës në familje dhe Planit të Veprimit 2016-2018 për Komunën e Vitisë.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Strategjia komunale kundër dhunës në familje dhe Planit të Veprimit 2016-2018 për Komunën e Vitisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi, Strategjisë komunale kundër dhunës në familje dhe Planit të veprimit 2016-2018 do të kujdeset Njësia për të Drejtat e Njeriut, Qendra për Punë Sociale, Policia e Kosovës dhe organet tjera komunale të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Njesisë për të drejtat e njeriut
2. Qendrës për punë sociale,
3. Policisë së Kosovës
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
K R Y E S U E S I

Naim Pira

